



BASHKIMI I SINDIKATAVE TË PAVARURA TË KOSOVËS
THE UNION THE INDEPENDENT OF KOSOVO

Nr. fiskal : 600268793

Adresa: Rr. Nëna Terezë Nr. 35 10000 Prishtinë

Tel 038 222-859

Fax. 038 224-649

E mail: bspk@bspk.org

Pas shqyrtimit të deklaratës së Kryeministrit të Kosovës z. Isa Mustafa, se në vitin e ardhshëm nuk do të ndodhë ngritja e premtuar e pagave për shërbyesit civilë, Kryesia e BSPK-ës lëshon këtë:

K O M U N I K A T Ë

Ndonëse nga shërbyesit civilë të Kosovës pritej me padurim ngritja e pagave për vitin e ardhshëm prej 25 % që ishte premtuar nga ish Kryeministri i Kosovës z. Hashim Thaqi, tani Zëvendës Kryeministër, BSPK ndjehet e zhgënjyer me deklaratën e Kryeministrit të porsazgjedhur të Kosovës z. Isa Mustafa se kjo ngritje nuk do të ndodhë.

BSPK konsideron se mos respektimi i premtimit për ngritjen e pagave për shërbyesit civilë është një shpërfillje eklatante ndaj kësaj kategorie punëtorësh.

Nëse nuk do të respektohet premtimi i dhënë, atëherë BSPK do t'i shqyrtoj edhe variantet e lejueshme të veprimit sindikal për realizimin e të drejtave që u përkasin.

Prishtinë , 12.12.2014

ZYRA PËR INFORMIM E BSPK-ës

Dafina Mehaj